



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

## NJOFTIM

### Për Shtesë Në Rendin E Ditës Në Mbledhjen e Radhës

Në mbështetje të nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 , neni 55 pika 5, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

#### NJOFTON:

DITËN E ENJTE, DATË 25.02.2021, ORA 12:00, NË MBLEDHJEN E RRADHËS QË DO TË MBAJ KËSHILLI NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, DO TË KEMI SHTESA, ME KËRKESË TË BASHKISË Durrës, NË RENDIN E DITËS SI MË POSHTË:

****	MIRATIMI I SHTESAVE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
<b>Pika 6.</b> Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA "26 NËNTORI" DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA "PETRAQ BOSHNIJAKU" NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
<b>Pika 7.</b> Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 1 (NJË) OBJEKTI BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, Durrës, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS TË THELLUAR, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet, do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, neni 34 pika 1, neni 77 pika 8, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

**DATA 24.02.2021** Pika 6, do të shqyrtohet, ora 17:00, nga:

- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
  - Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **20.00**

**DATA 24.02.2021** Pika 7, do të shqyrtohet, ora 18:00, nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
  - Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
  - Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
- dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **20.30**

**SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**

**Dorina Milja**